



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 36 prot.

Kamëz, më 11.3.2022

V E N D I M

Nr. 32 Datë 11 / 3 2022

MBI

MIRATIMIN E MARRJES ME QIRA TË AMBJENTEVE PRIVATE PËR KOPSHTIN  
NR.6 'ELFËT '

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot më 11.03.2022 në kushte të veçanta si pasojë e masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19 , pasi mori në shqyrtim Projekt-Vendim Nr.29 Datë 09.03.2022 në mbështetje të nenit 23 ku parashikohen "Funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike " pika 11 dhe 12 të Ligjit Nr. 139/2015 " Për Vetëqeverisjen Vendore ", e cila ngarkon Njësitë Bazë të Qeverisjes Vendore me " Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale" si dhe me "...administrimin dhe rregullimin e sistemit parashkollorë dhe arsimorë "; **Këshilli Bashkiak Kamëz;**

V E N D O S I:

1. Marrjen me qira të një ambienti privat për një periudhë 1 (një) vjeçare për kopshtin Nr. 6 " ELFËT " i ndodhur në adresën: Rruga " Nënë Tereza ", Laknas, Kamëz.
2. Vlera e qirasë do të përcaktohet me lidhjen e kontratës konform legjislacionit në fuqi.
3. Fondet për marrjen me qira të këtyre ambienteve, janë parashikuar në buxhetin e Bashkisë Kamëz për vitin 2022, miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 132, datë 22.12.2022 në zërin buxhetor Gr.00, Prog. 09120, art 602.
4. Ngarkohen për zhvillimin e procedurave të mëtejshme Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit, në Bashkinë Kamëz.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga **Prefekti i Qarkut Tiranë**.

Kryetar Këshilli  
Hysen KOLDASHI

